



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 03/L-113

PËR TATIMIN NË TË ARDHURAT E KORPORATAVE

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

Miraton

LIGJ PËR TATIMIN NË TË ARDHURAT E KORPORATAVE

KREU I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Përkufizimet

Sipas këtij ligji termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

“**Pasuri kapitale**” do të thotë pasuri e prekshme me afat të përdorimit për një apo më shumë vite.

“**Dividendë**” do të thotë pjesa të cilën kompania ia ndan një aksionari nga:

- Paratë e gatshme ose stoqet në bazë të pjesës së interesit të aksionarit në kompani dhe

- Prona tjetër, pos parave të gatshme ose e stoqeve, përveç nëse shpërndarja bëhet si rezultat i likuidimit;

“Veprimtari ekonomike” do të thotë veprimtaria e ushtruar me qëllim të fitimit të të ardhurave.

“Pasqyrë financiare” do të thotë pasqyrat financiare të karakterit të përgjithshëm të përgatitura në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/30 të datës 29 tetor 2001 mbi themelimin e Bordit të Kosovës për standardet e raportimit financiar dhe të një regjimi për raportimin financiar të organizatave afariste.

“Të ardhurat e burimeve të jashtme” do të thotë të ardhurat bruto që nuk janë të ardhura të brendshme të Kosovës.

“Të ardhurat bruto” do të thotë të gjitha të ardhurat e fituara ose të akumuluar, duke përfshirë mes tjerash, të ardhurat nga veprimtaritë e prodhimit, tregtisë, financave, investimeve, veprimtarisë profesionale ose veprimtarive të tjera ekonomike.

“Pronë e paprekshme” nënkupton patentet, të drejtën e autorit, licencat, të drejtat ekskluzive dhe pronën tjetër që përbëhet vetëm nga të drejtat, por që nuk ka formë fizike.

“Pasuri e paluajtshme” do të thotë e tërë toka dhe ndërtesat dhe të gjitha njësitë në kuadër të ndërtesave siç janë banesat apo hapësirat për qëllime komerciale

“Pronësi në pasurinë e paluajtshme” do të thotë e tërë pasuria e paluajtshme dhe ndërtesat apo strukturat nën dhe mbi sipërfaqen tokësore dhe të lidhura me tokën.

“Shndërrim jo i vullnetshëm” nënkupton pasurinë e plotë ose të pjesshme që është shkatërruar, vjedhur, konfiskuar apo është shpallur e papërdorshme, ose kur tatimpaguesi është i detyruar të heqë dorë prej saj për shkak të çfarëdo kërcënimi ose rreziku të përmendur më parë.

“Të ardhura nga burimet e Kosovës” do të thotë të ardhura bruto që krijohen në Kosovë, të cilat përfshijnë:

- të ardhurat nga veprimtaritë afariste të ushtruara në Kosovë;
- të ardhurat nga shfrytëzimi i pasurisë së tundshme dhe të patundshme në Kosovë;
- të ardhurat nga shfrytëzimi i pasurisë së paprekshme në Kosovë;
- kamata mbi obligimin e borxhit e paguar nga rezidenti apo autoriteti publik;
- dividendin nga një kompani vendëse;

- fitimin nga shitja e pasurisë së patundshme që ndodhet në Kosovë;
- të ardhura tjera që nuk janë të mbuluara me nën-paragrafët e lartpërmendura që dalin nga veprimtaria ekonomike në Kosovë.

“**Vlera e tregut**” do të thotë çmimi me të cilat mallrat apo shërbimet e ngjashme të cilësisë dhe të sasisë së njëjtë do të shiteshin në një transaksion duar lirë.

“**Jorezident**” do të thotë një person ose grup personash që nuk janë banorë të Kosovës.

1A.1 “Ndërmarrje e Përhershme” do të thotë vend i caktuar i veprimtarisë afariste ku veprimtaria afariste e personit jo rezident zhvillohet tërësisht apo pjesërisht në Kosovë.

1A.2 “Ndërmarrje e përhershme” përfshin:

- (a) çdo vend i menaxhmentit;
- (b) çdo degë;
- (c) çdo zyrë;
- (d) çdo fabrikë;
- (e) çdo punëtori;
- (f) çdo minierë dhe
- (g) çdo burim i naftës dhe gazit, gurore ose vend tjetër i shfrytëzimit të burimeve natyrore.

1A.3 “Ndërmarrje e përhershme” gjithashtu përfshin;

(a) çdo vend ndërtimi, ndërtim, montim ose projekt instalimi, ose ndonjë aktivitet mbikëqyrës në lidhje me këtë, por vetëm nëse ndërtimi, projekti ose aktiviteti i tillë zgjat më shumë se njëqindetëdhjetë (183) ditë. Kur vend ndërtimi, projekti ose aktiviteti zgjat më shumë se njëqindetëdhjetë (183) ditë, duke përfshirë edhe aktivitetet përgatitore, vend ndërtimi, projekti apo aktiviteti konsiderohet se ka qenë apo është krijuar si ndërmarrje e përhershme nga dita kur ka filluar puna e tillë;

(b) Ofrimin e ndonjë shërbimi, duke përfshirë shërbime të konsultimeve, por duke përjashtuar aktivitetet e mbikëqyrjes të parapara në nenin 1A.3(a) të kryera në Kosovë nga personi jo rezident përmes punëtorëve ose personelit tjetër, por vetëm nëse aktivitetet e tilla vazhdojnë brenda Kosovës për një periudhë apo periudha gjithsejtë nëntëdhjetë (90) ditore apo më shumë brenda një periudhe dymbëdhjetë mujore. Kur aktivitetet vazhdojnë brenda Kosovës për një periudhë apo periudha gjithsejtë nëntëdhjetë (90) ditore ose më shumë gjatë një periudhe

dymbëdhjetë mujore, aktivitetet konsiderohet se kanë krijuar ndërmarrje të përhershme nga dita kur kanë filluar aktivitetet e tilla;

(c) Çdo vend ndërtimi i shfrytëzuar për kërkimin e resurseve natyrore brenda Kosovës, kur aktivitetet e tilla brenda Kosovës vazhdojnë për një periudhë apo periudha gjithsejtë njëqindetëdhjetetë (183) ditore apo më shumë brenda cilësdo periudhe dymbëdhjetë mujore. Kur aktivitetet vazhdojnë për një periudhë apo periudha gjithsejtë njëqindetëdhjetetë (183) ditore ose më shumë brenda një periudhe dymbëdhjetë mujore, aktivitetet konsiderohen se kanë krijuar ndërmarrje të përhershme nga dita kur kanë filluar aktivitetet e tilla; dhe

(d) Çdo pasuri e paluajtshme që ndodhet në Kosovë dhe posedohet nga një person jo rezident.

1A.4 Pavarësisht nga nenet 1A.1 dhe 1A.2 të këtij neni, kur personi, përveç agjentit me status të pavarur për të cilin zbatohet neni 1A.7, vepron në Kosovë në emër të personit jo rezident, personi jo rezident konsiderohet se ka ndërmarrje të përhershme në Kosovë lidhur me aktivitetet që ai person i ndërmerr për personin jo rezident, nëse personi i tillë:

(a) Ka dhe zakonisht ushtron autorizimin në Kosovë për të lidhur kontrata në emër të personit jo rezident, përveç nëse aktivitetet e personit të tillë janë të kufizuara në ato të përmendura në nenin 1A.6 të cilat, nëse ushtrohen përmes një vendi të caktuar të biznesit, nuk do ta bënin këtë vend të caktuar të biznesit ndërmarrje të përhershme sipas dispozitave të atij nën neni; ose

(b) Nuk ka autorizim të tillë, por zakonisht mban një magazinë të mallrave ose materialeve në Kosovë nga i cili vazhdimisht shpërndan mallra ose materiale në emër të tatimpaguesit.

1A.5 Personi jo rezident i cili ofron sigurim, përveç risigurimit, konsiderohet se ka ndërmarrje të përhershme në Kosovë nëse mbledh shpërblime në Kosovë ose siguron rreziqet që ndodhen në Kosovë përmes një personi, përveç agjentit me status të pavarur për të cilin zbatohet neni 1A. 7.

1A.6 Pavarësisht nën neneve 1A.1, 1A.2 dhe 1A.3 të këtij neni, “ndërmarrje e përhershme” konsiderohet se nuk përfshin:

(a) Shfrytëzimin e objekteve vetëm me qëllim të ruajtjes ose ekspozimit të mallrave ose materialeve që i përkasin personit jo rezident;

(b) Mbajtja e magazinës së mallrave dhe materialeve që i përkasin personit jo rezident vetëm me qëllim të ruajtjes apo ekspozimit;

(c) Mbajtja e magazinës së mallrave dhe materialeve që i përkasin personit jo rezident vetëm për qëllime të procesimit nga një tatimpagues tjetër;

(d) Mbajtja e një vendi të caktuar të biznesit vetëm me qëllim të blerjes së mallrave ose materialeve ose mbledhjes së informacioneve për personin jo rezident;

(e) Mbajtja e një vendi të caktuar të biznesit vetëm për qëllimin e kryerjes së aktiviteteve të tjera të karakterit përgatitor apo ndihmës për personin jo rezident; dhe

(f) Mbajtja e një vendi të caktuar të biznesit vetëm për kombinimin e ndonjë nga aktivitetet e paraqitura në paragrafin (a) deri (e) të këtij nën neni, me kusht që aktiviteti i përgjithshëm i vendit të caktuar të biznesit që rezulton nga ky kombinim ka vetëm karakter përgatitor apo ndihmës.

1A.7 Personi jo rezident nuk konsiderohet se ka ndërmarrje të përhershme në Kosovë vetëm pse kryen veprimtari afariste në Kosovë përmes komisionerit, agjentit të përgjithshëm të komisionit apo ndonjë agjenti tjetër me status të pavarur, me kusht që personat e tillë veprojnë sipas rrjedhës së rëndomtë të biznesit të tyre.

Mirëpo, kur aktivitetet e agjentit të tillë kushtohen tërësisht apo gati tërësisht në emër të atij taksapaguesi, dhe krijohen kushtet apo imponohen ndërmjet atij taksapaguesi dhe agjentit në marrëdhëniet e tyre komerciale dhe financiare që ndryshojnë nga ata që do të kishin mundur të bëhen ndërmjet taksapaguesve të pavarur, ai nuk konsiderohet agjent me status të pavarur në kuptimin e këtij nën neni.

1A.8 Fakti se personi jo rezident kontrollon ose kontrollon nga një kompani që është rezidente e Kosovës, apo që kryen biznes në Kosovë (qoftë përmes ndërmarrjes së përhershme apo ndryshe), nuk e konsideron asnjëherë kompani ndërmarrje të përhershme të tjetrës.

“Person” do të thotë person juridik ose fizik.

“Autoritet publik” do të thotë një autoritet qendror, rajonal, komunal ose lokal, organ publik, ministri, departament apo ndonjë autoritet tjetër që ushtron pushtet publik ekzekutiv, ligjvënës, rregullator, administrativ ose pushtet gjyqësor.

“Person i afërm” do të thotë persona me lidhje të veçanta që mund të ndikojnë materialisht në rezultatet ekonomike të transaksioneve ndërmjet tyre. Personat konsiderohen se kanë lidhje të veçantë nëse:

- janë zyrtarë ose drejtorë të bizneseve të njëri-tjetrit;
- janë partnerë të ligjshëm në biznes;
- kanë lidhje punëdhënësi-punonjësi;
- një person që mban ose kontrollon pesëdhjetë për qind (50 %) a më shumë të aksioneve ose të të drejtave të votimit në kompaninë e personit tjetër;
- njëri prej tyre drejtpërsëdrejti ose tërthorazi e kontrollon tjetrin;
- që të dytë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi kontrollohen nga një person i tretë apo
- ata janë anëtarë të së njëjtës familje duke përfshirë bashkëshortin ose bashkëshorten paraardhësin ose pasardhësin, vëllain ose motrën, nipin ose mbesën, bashkëshortin e motrës ose të vëllait, motrën ose vëllain e njërit prind ose të vjehrrit, kunetërit ose kunatat.

“Shpenzimet e reprezentacionit” do të thotë të gjitha shpenzimet lidhur me promovimin e biznesit ose të produkteve të tij të cilat përfshijnë shpenzimet e publicitetit, reklamimit, zbavitjes dhe reprezentacionit.

“Rezident” do të thotë një person ose grup i personave që është i vendosur në Kosovë ose që e ka vendin e vet të menaxhimit efektiv në Kosovë.

“Periudha tatimore” do të thotë viti kalendarik.

Neni 2 Tatimpaguesit

1. Sipas këtij ligji tatimpagues janë personat e mëposhtëm:

1.1. një korporatë apo ndonjë ndërmarrje tjetër afariste që ka statusin e personit juridik sipas ligjit në fuqi në Kosovë;

1.2. një ndërmarrje afariste që vepron me pasuri në pronësi shoqërore ose publike;

1.3. një organizatë e regjistruar si organizatë joqeveritare në bazë të legjislacionit mbi regjistrimin dhe punën e organizatave joqeveritare në Kosovë; dhe

1.4. Person jo rezident me ndërmarrje të përhershme në Kosovë, duke iu nënshtruar dispozitës së paragrafit 2 të nenit 3 të këtij ligji.”

Neni 3 Objekti i Tatimit

1. Objekt i tatimit për tatimpaguesin rezident është tatimi në të ardhura nga burimet e të ardhurave në Kosovë dhe burimit të ardhurave të jashtme

2. Objekt i tatimit për tatimpaguesin jo rezident është tatimi në të ardhura nga burimi i të ardhurave brenda Kosovës.

Neni 4 Të ardhurat e tatueshme

1. Një tatimpagues me të ardhura bruto prej pesëdhjetëmijë e një (50.001) eurosh apo më shumë, llogaritë të ardhurat e tatueshme duke përgatitur pasqyrën financiare dhe duke bërë përshtatjen e të ardhurave e shpenzimeve të regjistruara në pasqyrat e tilla, siç është paraparë me këtë ligj.

2. Një tatimpagues me të ardhura vjetore bruto prej pesëdhjetëmijë (50.000) eurosh apo më pak, llogaritë të ardhura të tatueshme:

2.1. në përputhje me nën-paragrafëve 2.1. dhe 2.2 të paragrafit 2. të nenin 31 të këtij ligji ose

2.2. duke përgatitur pasqyrat financiare dhe duke përshtatur të ardhurat dhe shpenzimet e regjistruara në pasqyrat e tilla në mënyrën e përkufizuar me këtë ligj.

3. Tatimpaguesit që zgjedhin të llogarisin të ardhurat e tatueshme dhe të përgatisin pasqyrat financiare sipas nën-paragrafit 2.2. të paragrafit 2. të këtij neni në çfarëdo periode të tatimit duhet të llogarisin të ardhurat e tatueshme dhe të përgatisin pasqyrat financiare në atë mënyrë për secilën periudhë pasuese të tatimit.

4. Si përjashtim ndaj nën-paragrafëve më lart, tatimpaguesit veprimtaria kryesore e të cilëve është sigurimi dhe risigurimi i jetës, pasurisë apo nga rreziqet tjera, llogarisin të ardhurat e tatueshme dhe paguajnë tatim në të ardhura në pajtim me nenin 28 të këtij ligji.

Neni 5 Shkalla e tatimit

Për periudhën tatimore për vitin 2009 dhe për periudhat tatimore pasuese, tatimi në të ardhurat e korporatave është dhjetë për qind (10%) nga të ardhurat e tatueshme.

KREU II

TË ARDHURAT QË LIROHEN NGA TATIMI

Neni 6 Të ardhurat e liruara

1. Të ardhurat si në vijim lirohen nga tatimi në të ardhurat e korporatave:

1.1. Pa paragjykuar nenin 29 të këtij ligji, të ardhurat e organizatave të regjistruara sipas legjislacionit mbi regjistrimin e punës dhe veprimtarisë së organizatave si organizata joqeveritare që kanë fituar dhe mbajtur statusin e beneficuar publik me kusht që të ardhurat të shfrytëzohen vetëm për qëllime bamirëse;

1.2. Të ardhurat e Bankës Qendrore të Kosovës dhe të institucioneve financiare ndërqeveritare e ndërkombëtare të lejuara dhe të autorizuar për të vepruar në Kosovë;

1.3. Dividendët që merren nga një tatimpagues rezident i një kompanie rezidente që ka paguar tatimin e Kosovës në të ardhurat e korporatave; dhe

1.4. Të ardhurat nga një kontraktues, përveç një kontraktuesi vendës, që janë krijuar nga kontratat për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve të Kombeve të Bashkuara (duke

përfshirë UNMIK-un), agjencitë e specializuara të Kombeve të Bashkuara dhe Agjencinë Ndërkombëtare për Energji Bërthamore.

KREU III

SHPENZIMET

Neni 7

Shpenzimet e lejueshme

1. Në varësi të kufizimeve të këtij ligji, në përcaktimin e të ardhurave të tatueshme, tatimpaguesit i lejohet zbritje nga të ardhurat bruto të paguara ose të bëra vetëm gjatë periodës tatimore në tërësi dhe ekskluzivisht përkitazi me veprimtarinë e tij ekonomike.
2. Nuk lejohet zbritje për kurrfarë shpenzimesh përveç nëse dokumentohet sipas mënyrës së paraparë me udhëzimin administrativ që do ta nxjerrë Ministria për Ekonomi dhe Financa.

Neni 8

Shpenzimet e palejueshme

1. Gjatë përcaktimit të të ardhurave të tatueshme shpenzimet e mëposhtme janë të palejueshme:
 - 1.1. shpenzimet e përvetësimit dhe përmirësimit të tokës;
 - 1.2. shpenzimet e përvetësimit, përmirësimit, ripërtëritjes dhe rindërtimit të mjeteve të cilat janë zhvlerësuar ose amortizuar në bazë të dispozitave të këtij ligji;
 - 1.3. gjobat dhe dënimet;
 - 1.4. tatimi në të ardhura; dhe
 - 1.5. tatimi në vlerën e shtuar për të cilin tatimpaguesi kërkon zbritje ose kredi për tatimin në repromaterial në bazë të legjislacionit për Tatimin në Vlerën e Shtuar në Kosovë.

Neni 9

Zbritjet e lejueshme

1. Kontributet e dhëna për qëllime humanitare, shëndetësore, edukativo-arsimore, fetare, shkencore, kulturore, mbrojtje të ambientit dhe për qëllime sportive sipas këtij ligji lejohen si shpenzime deri në maksimumin prej 5 për qind (5%) të të ardhurave të tatueshme të llogaritura para zbritjes së shpenzimeve.

2. Një kontribut i lejueshëm sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet t'i bëhet:

2.1. një organizate të regjistruar sipas sipas legjislacionit mbi regjistrimin dhe funksionimin si një organizatë joqeveritare që ka pranuar dhe mbajtur statusin e beneficuar publik;

2.2. çdo organizate tjetër jo komerciale që në mënyrë të drejtpërdrejtë kryen aktivitet me interes publik dhe jo për përfitim, siç janë:

2.2.1. institucionet shëndetësore;

2.2.2. institucionet edukativo-arsimore;

2.2.3. organizatat për mbrojtjen e mjedisit;

2.2.4. institucionet fetare;

2.2.5. institucionet që përkujdesen për persona të paafte apo për persona të vjetër;

2.2.6. jetimoret dhe

2.2.7. institucionet në përkrahje të shkencës, kulturës, sportit apo të arteve.

3. Zbritja e lejueshme nuk përfshinë kontributin nga i cili drejtpërsëdrejti përfitojnë personat e afërm me donatorin.

4. Secili tatimpagues që kërkon zbritje të lejueshme duhet të dorëzojë deklaratën vjetore tatimore në përputhje me paragrafin 2 të nenit 30 të këtij ligji dhe t'i paraqesë Administratës tatimore dëftesën e pagesës për një zbritje të tillë.

Neni 10

Shpenzimet e reprezentacionit

Sipas këtij ligji shpenzimet për reprezentacion lejohen deri në maksimumin prej dy për qind (2%) të të ardhurave bruto.

Neni 11

Borxhet e këqija

1. Borxhe të këqija sipas këtij Ligji konsiderohen shpenzimet që i përmbushin të tri (3) kushtet e mëposhtme:

1.1. nëse shuma që i përgjigjet borxhit është përfshirë më parë në të ardhura;

1.2. nëse borxhet janë shlyer në librat e tatimpaguesit si të pavlefshme; dhe

1.3. nëse ekziston dëshmi adekuate e përpjekjeve të mëdha të pasuksesshme të bëra nga tatimpaguesi për arkëtimin e borxhit.

2. Borxhet e këqija që janë zbritur si shpenzime dhe pastaj janë arkëtuar më vonë, përfshihen si të ardhura në momentin e arkëtimit.

Neni 12 **Fondet rezervë**

1. Përveç nëse është paraparë ndryshe në këtë ligj, kontributet në fondet rezervë nuk lejohen si shpenzime

2. Bankat kanë të drejtë në shpenzime për krijimin e fondit të posaçëm rezervë për mjetet e dyshimta të bankës në shumën e cila nuk duhet të kalojë shumën maksimale të lejueshme nga Banka Qendrore e Kosovës.

3. Pas krijimit të fondit të posaçëm rezervë, çdo shumë e tërhequr prej fondit duhet të përfshihet në të ardhura dhe në çdo shumë të kthyer në fond për ta rimbushur atë deri në shumën e lejueshme lejohet si zbritje.

Neni 13 **Pagesat për personat e afërm**

1. Kompensimi ose pagat e paguara për personin e afërm lejohen si shpenzime në shumën e barabartë me pagën aktuale minimale apo me çmimin e tregut.

2. Kamata, qiraja dhe shpenzimet tjera që i paguhen personit të afërm lejohen si shpenzime në shumën e barabartë me pagën aktuale minimale apo me çmimin e tregut

Neni 14 **Zhvlerësimi**

1. Shpenzimet për pronën e prekshme përveç shpenzimeve për tokën, veprat artistike dhe pronën tjetër e cila nuk konsumohet që i posedon tatimpaguesi dhe që shfrytëzohen për veprimtarinë ekonomike të tatimpaguesit do të kompensohen me kalimin e kohës përmes zbritjeve të zhvlerësimit në mënyrën e përcaktuar me këtë nen.

2. Shpenzimet për përmirësimin e pronave me qira të cilat përdoren për veprimtari ekonomike të tatimpaguesit do të kompensohen përmes zbritjeve të zhvlerësimit të llogaritura me metodën lineare për periodën e kohëzgjatjes së qirasë.

3. E gjithë prona materiale e tatimpaguesit që i nënshtrohet zhvlerësimit sipas nën-paragrafit 1. të këtij neni caktohet në një rën prej kategorive vijuese:

(a) Kategoria 1: Ndërtesat dhe strukturat tjera ndërtimore;

(b) Kategoria 2: Veturat dhe kamionët e lehtë, mjetet e rënda për transport, pajisjet për bartje të dheut, buldozerët, gërmuesit e dheut dhe mjetet tjera të rënda, kompjuterët, pjesët shtesë për kompjuterë dhe pajisjet tjera për përpunimin e të dhënave, mobiliet dhe pajisjet për zyra, instrumentet, gjërat e ndryshme dhe pajisjet tjera shtesë;

(c) Kategoria 3: Uzinat dhe makineritë, inventari i hekurudhës dhe lokomotivat që përdoren për transport hekurudhor, aeroplanët, anijet dhe e tërë pasuria tjetër materiale.

4. Prona në secilën kategori trajtohet si më poshtë:

(a) Kategoria 1: prona evidencohet në llogari të ndara të mjeteve;

(b) Kategoria 2: prona evidencohet në llogari të ndara të mjeteve;

(c) Kategoria 3: prona bashkohet dhe vendoset në një llogari të konsoliduar të kapitalit.

5. Shuma e lejuar si zbritje për zhvlerësim në periudhën tatimore përcaktohet duke aplikuar përqindjet e mëposhtme për llogaritjen e kapitalit të një kategorie të tillë sipas metodës së drejtpërdrejtë në fund të periudhës tatimore:

(a) Kategoria 1 - pesë për qind (5%).

(b) Kategoria 2 - njëzet për qind (20%) dhe

(c) Kategoria 3 - pesëmbëdhjetë për qind (15%).

6. Sipas këtij neni, një pasuri së pari duhet të merret parasysh kur vihet për herë të parë në shërbim.

7. Shtimi fillestar në llogarinë kapitale për ndonjë pasuri të përvetësuar gjatë vitit duhet të jetë çmimi i saj plus sigurimi dhe bartja. Plotësimi fillestar i llogarisë kapitale për ndonjë pronë të ndërtuar nga tatimpaguesi përfshinë tatimet, detyrimet dhe kamatën që i ngarkohet kësaj prone për periudhat para se të vihet në shërbim prona.

8. Shpenzimi për ndonjë pasuri më të vogël se një mijë (1000) euro, që i përket kategorisë 2 ose 3, lejohet si shpenzim rrjedhës.

Neni 15

Zbritjet e posaçme për pasuritë e reja

1. Nëse një tatimpagues blen ndonjë pasuri që i përket kategorisë 3 për qëllimet e veprimtarisë ekonomike të tatimpaguesit ndërmjet 1 janarit 2005 dhe 31 dhjetorit 2008, lejohet një zbritje e veçantë prej dhjetë për qind (10%) të çmimit të përvetësimit të pasurisë në vitin në të cilin pasuria është vënë për herë të parë në shërbim. Kjo zbritje do bëhet përveç zbritjes normale të zhvlerësimit të lejueshëm. Zbritja lejohet vetëm nëse pasuria është e re ose është vënë për herë të parë në shërbim në Kosovë. Zbritja nuk lejohet nëse pasuria është bartur nga një biznes ekzistues ose një biznes i mëparshëm në Kosovë.

2. Zbritjet tjera të posaçme mund të jepen vetëm nëse parashihen në ligj e caktuar.

Neni 16

Riparimet dhe Përmirësimet

1. Në rastin e llogarive të mjeteve të ndara dhe të ndonjë llogarie të mjeteve të grumbulluara:

1.1. shumat e tilla lejohen si zbritje për atë vit nëse ato mjete të shpenzuara gjatë periudhës tatimore për të riparuar, mirëmbajtur ose përmirësuar pronën nuk kalojnë shumën prej pesë për qind (5%) të bilancit të llogarisë në fillim të atij viti; dhe

1.2. tejkalimet e tilla trajtohen si përmirësime dhe i shtohen llogarisë së mjeteve të ndara ose llogarisë së grumbulluar, nëse shumat e tilla janë më të mëdha se pesë (5%) për qind.

Neni 17

Amortizimi

1. Shpenzimet për mjetet e paprekshme, të cilat kanë afat të kufizuar përdorimi, duke përfshirë patentën, të drejtat e autorit, licencat për vizatime apo modele, kontratat dhe të drejtat ekskluzive, zbriten në formë të detyrimeve të amortizimit.

2. Metoda e amortizimit do të jetë metoda e shlyerjes lineare dhe zbritja bazohet në afatin e përdorimit të pasurisë të përcaktuar në marrëveshjen ligjore mbi përvetësimin dhe përdorimin e pasurisë së paprekshme.

Neni 18

Shpenzimet kërkimore dhe zhvillimore

1. Të gjitha shpenzimet për kërkime dhe zhvillim lidhur me rezervat natyrore të mineraleve dhe të resurseve të tjera natyrore, si dhe kamatat që u ngarkohen, i shtohen llogarisë kapitale dhe amortizohen sipas këtij neni.

2. Shuma e lejuar si zbritje për amortizim përkitazi me shpenzimet kërkimore dhe zhvillimore, e cekur në paragrafin 1. të këtij neni për periudhën tatimore, përcaktohet duke shumëzuar bilancin në llogarinë kapitale me një shumë:

2.1. numëruesit i së cilës paraqet njësitë e nxjerra prej rezervave natyrore gjatë vitit; dhe

2.2. emëruesi i së cilës paraqet shumën e njërive të përgjithshme të parapara për t'u nxjerrë nga rezervat natyrore gjatë jetëgjatësisë së pasurisë.

3. Njësitë e përgjithshme të parapara për nxjerrje, të referuara në nën-paragrafin 2.2. të paragrafit 2. të këtij neni do të përcaktohen në mënyrën e cila do të përshkruhet në një udhëzim të ardhshëm administrativ që do të lëshohet nga Ministria për Ekonomi dhe Financa.

KREU IV

FITIMET DHE HUMBJET NË KAPITAL, HUMBJET NË BIZNES

Neni 19

Fitimet dhe humbjet në kapital

1. Fitimet në kapital nënkuptojnë të ardhurën, të cilën tatimpaguesi e realizon përmes shitjes apo disponimit të pasurive kapitale duke përfshirë pasurinë e patundshme dhe letrat me vlerë.

2. Shuma e fitimit në kapital paraqet dallimin pozitiv të çmimit të shitjes së pasurisë kapitale dhe të çmimit të pasurisë siç është përcaktuar në paragrafin 7. të këtij neni.

3. Humbje në kapital do të thotë humbje, të cilën tatimpaguesi e pëson përmes shitjes apo tjetërsimit në ndonjë mënyrë tjetër të pasurisë kapitale, duke përfshirë patundshmëritë dhe letrat me vlerë.

4. Shuma e humbjes në kapital paraqet dallimin negativ të çmimit të shitjes së pasurisë dhe të çmimit të pasurisë siç është përcaktuar në paragrafin 7. të këtij neni.

5. Çmimi i shitjes së pasurisë kapitale është çfarëdo shume e parave të pranuar plus vlera e tregut e cilëso prone përveç parave të pranuar si kundërvlerë për shitje.

6. Nëse palët janë persona të afërt dhe se çmimi i shitjes është më i ulët se vlera e tregut, atëherë sipas këtij neni, çmimi i shitjes do të jetë i barabartë me vlerën e tregut.

7. Kostoja e pasurisë kapitale është shumë, të cilën tatimpaguesi e ka paguar për përvetësimin e pasurisë kapitale që rritet me shpenzimet e përmirësimeve dhe zvogëlohet nga zhvlerësimet apo shpenzimet tjera të lejueshme sipas këtij ligji.

8. Ky nen nuk vlen për pasuritë kapitale që i nënshtrohen zhvlerësimit si pasuri të grumbulluara.
9. Fitimet në kapital njihen si të ardhura afariste dhe humbjet në kapital njihen si humbje afariste.

Neni 20 **Ndërrimet e paqëllimshme**

Fitimi në kapital nuk pranohet në rast të ndërrimit pa dashje të pronës nëse kompensimi i marrë nga ndërrimi përbëhet nga prona e karakterit a e natyrës së njëjtë ose nga natyra a paratë që janë investuar në pronën e natyrës apo të karakterit të njëjtë brenda periudhës dy (2) vjeçare të zëvendësimit

Neni 21 **Humbjet afariste**

1. Humbjet afariste janë dallimi negativ ndërmjet të ardhurave të tatimpaguesit dhe shpenzimeve të dala nëpërmjet aktiviteteve ekonomike.
2. Shuma e humbjes së biznesit e përcaktuar sipas këtij neni mund të bartet deri në shtatë (7) periudha të njëpasnjëshme tatimore dhe është e disponueshme si zbritje ndaj çfarëdo të ardhure për ato vite.
3. Shuma e bartur që merret parasysh për çfarëdo periudhe tatimore pas vitit të humbjes afariste do të jetë shuma e përgjithshme e humbjes e zvogëluar për shumën e grumbulluar që është lejuar më parë si zbritje.
4. Nëse tatimpaguesi ka pasur humbje afariste më gjatë se një (1) vit, ky nen zbatohet për humbjet që janë krijuar sipas radhës.

KREU V

LIKUIDIMET DHE RIORGANIZIMET

Neni 22 **Shpërndarja e pronës**

1. Kompania që ia shpërndan pronën (përveç aksioneve) një aksionari, duke pasur parasysh interesin e aksionarit, njih fitim ose humbjen sikur ajo pronë t'i ishte shitur aksionarit në vlerën e saj të tregut.

2. Vlera e pronës së shpërndarë për aksionarin vlerësohet sipas vlerës së pronës në treg.
3. Në rast të shpërndarjes së dividendëve të aksioneve që nuk ndërrojnë hisen e pjesëmarrjes së fituesit, kompania nuk e njih fitimin as humbjen dhe kështu aksionari nuk realizon të ardhura.

Neni 23 Likuidimi

1. Në rast të likuidimit të një kompanie, kompania merr parasysh humbjen apo fitimin sikur ta kishte shitur pronën që është shpërndarë gjatë likuidimit sipas vlerës së saj në treg.
2. Përveç nëse është paraparë ndryshe në këtë ligj, pranuesit e pronës së shpërndarë gjatë likuidimit trajtohen sikur ta kishin këmbyer interesin e vlerës së mbetur në kompaninë e likuiduar për shumën që është e barabartë me vlerën e asaj prone në treg.
3. Në rast të likuidimit të një filiali ku prona e filialit i shpërndahet një filiali amë, filiali amë nuk pranon kurrfarë humbjesh apo fitimesh.

Neni 24 Riorganizimi

1. Transferimi i pronës në pajtim me planin e shkruar për riorganizimin e tatimpaguesit qoftë për shkak të bankrotimit, bashkimit, përvetësimit apo të ndonjë arsyeje tjetër, që e miraton Administrata tatimore, nuk i nënshtrohet tatimeve sipas këtij ligji.
2. Në rast të riorganizimit, vlera e pronës sipas librave të mbajtura nga tatimpaguesi i riorganizuar përcaktohet në bazë të vlerës së asaj prone në librin e llogarive menjëherë para riorganizimit.
3. Gjatë riorganizimit, shpërndarja e interesit të vlerës së mbetur nuk paraqet të ardhur të tatueshme për aksionarin.
4. Përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe me ndonjë udhëzim administrativ të nxjerrë nga Ministria për Ekonomi dhe Financa, tatimpaguesi përvetësues trashëgon dhe zëvendëson tatimpaguesin dorëzues përkitazi me inventarin, shumën e humbjes së bartur, konton e dividendës dhe të gjitha zërat tjerë.

KREU VI

ÇMIMET E TRANSFERIMIT, SHMANGIA E TATIMEVE TË DYFISHTA

Neni 25

Çmimet e transferimit

1. Çmimi që shfrytëzohet lidhur me transaksionet e mjeteve apo të obligimeve kontraktuese ndërmjet personave përkatës konsiderohet çmim transferi.
2. Çmimi që pritët të merret lidhur me transaksionet e pasurisë apo të obligimeve kontraktuese ndërmjet palëve që kanë arritur marrëveshje “duar lirë” konsiderohet të jetë çmim “duar lirë”.
3. Çmimi “duar lirë” përcaktohet sipas metodës krahasuese të çmimeve të pakontrolluara dhe, në rastet kur kjo nuk mund të shfrytëzohet përdoret metoda e çmimeve të rishitjes ose metoda e kostos-plus.
4. Dallimi ndërmjet çmimit “duar lirë” dhe çmimit të transferimit përfshihet në të ardhurën e tatueshme.

Neni 26

Shmangia e tatimeve të dyfishta

1. Tatimpaguesit me banim në Kosovë që përfiton të ardhura nga aktivitetet afariste jashtë Kosovës me anë të ndonjë biznesi të përhershëm jashtë Kosovës dhe që paguan tatim në atë fitim në cilindo shtet, sipas këtij ligji i lejohet një kredi tatimore në shumën që është e barabartë me tatimin e paguar në një shtet të tillë.
2. Çdo kredi tatimore sipas këtij neni kufizohet në shumën e tatimit që duhet të paguhet sipas këtij ligji për të ardhurën e realizuar në atë shtet.
3. Çdo marrëveshje e zbatueshme bilaterale për shmangien e tatimit të dyfishtë i shfuqizon dispozitat e këtij neni.

KREU VII

MOSPAGESA E TATIMEVE

Neni 27

Mos pagesa e tatimeve në dividendët, kamatat, përqindjen e fitimit dhe në qirat

1. Përveç rastit kur tatimpaguesi ka paguar tatimin në fitim për dividendët të shpërndara për banorin e Kosovës, secili tatimpagues që paguan dividendët, kamatat apo përqindjen e fitimit (nga e drejta e autorit, e patentës apo e shfrytëzimit të burimeve natyrore) personit me banim në Kosovë apo personave me banim jashtë Kosovës, mban 10% të tatimit në kohën e pagesës apo të kreditimit dhe e zbrit tatimin e mbajtur (të papaguar) në një llogari të caktuar nga Administrata tatimore në bankën e licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës.

2. Përveç rastit kur qiraja paguhet nga personi fizik, çdo tatimpagues që i paguan qira personave të cilët janë banorë të Kosovës apo atyre që nuk janë banorë të Kosovës mban dhjetë për qind (10%) të tatimit në kohën e pagesës apo të kreditimit dhe zbrit tatimin e mbajtur (papaguar) në një llogari të caktuar nga Administrata tatimore në bankën e licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës.

3. Çdo tatimpagues i cili paguan dividendët, kamatën, përqindjen e fitimit (nga e drejta e autorit, e patentës apo e shfrytëzimit të burimeve natyrore) dhe qiranë, që mban tatimin sipas këtij neni gjatë periudhës tatimore, me kërkesë të Administratës tatimore, ofron një certifikatë për mbajtjen e tatimit në formularin e caktuar nga Administrata tatimore deri më datën 1 mars të vitit pasues të periudhës tatimore.

KREU VIII

DISPOZITAT E VEÇANTA

Neni 28

Trajtimi i kompanive të sigurimit

Në rastin e ndonjë subjekti, aktiviteti kryesor i të cilit është sigurimi ose ri sigurimi i jetës, i pronës ose i rreziqeve të tjera, tatimi që caktohet me këtë ligj është shuma e cila është e barabartë me shtatë për qind (7%) të primeve bruto të grumbulluara gjatë periudhës tatimore.

Neni 29
Trajtimi i të ardhurave komerciale të organizatave joqeveritare

Organizatës joqeveritare, e cila ndërmerr aktivitete komerciale ose aktivitete të tjera që nuk janë të lidhura me qëllimin e saj publik, i caktohet tatimi në të ardhur në shkallë prej dhjetë për qind (10%) për të ardhurën nga një aktivitet i tillë i pa ndërlidhur biznesi të zvogëluar nga cilado zbritje, e cila është drejtpërdrejt e lidhur me kryerjen e biznesit të tillë dhe e cila është e lejuar nga Administrata tatimore.

KREU IX

DISPOZITAT ADMINISTRATIVE

Neni 30
Deklarimi i tatimeve

1. Tatimpaguesi nga i cili kërkohet apo i cili zgjedh të llogarisë të ardhurën e tatueshme duke përshtatur të ardhurat dhe shpenzimet në pasqyrat e tij financiare duhet t'ia dorëzojë Administratës tatimore deklaratën vjetore për tatim më datën 1 prill apo para kësaj date të vitit pasues të periudhës tatimore. Deklarata bëhet në formularët e paraparë nga Administrata tatimore dhe përmban, mes tjerash, të ardhurat bruto, zbritjet e lejueshme, të ardhurat e tatueshme dhe tatimin që duhet të paguhet sipas këtij Ligji. Së bashku me deklaratën tatimore, tatimpaguesit e tillë gjithashtu duhet t'ia dorëzojnë pasqyrat financiare të përpiluara në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/30.

2. Tatimpaguesi, i cili kërkon zbritje të lejueshme në pajtim me nenin 9, duhet t'ia dorëzojë administratës tatimore deklaratën vjetore për tatim më datën 1 prill apo para asaj date të vitit pasues të periudhës tatimore. Deklarata bëhet në formularët e paraparë nga Administrata tatimore dhe përmban, mes tjerash, të ardhurat bruto, zbritjet e lejueshme, të ardhurat e tatueshme dhe tatimin që duhet të paguhet sipas këtij ligji.

Neni 31
Pagesat e tatimit

1. Sipas këtij ligji, secili tatimpagues çdo tre muaj bën pagesat e tatimit në avancë në llogarinë e caktuar nga Administrata tatimore në bankën e licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës në datat apo para datave 15 prill, 15 korrik, 15 tetor dhe 15 janar për tremujorin kalendarik që pason menjëherë pas këtyre datave.

2. Shuma e secilës pagesë tremujore në avancë është si në vijim:

2.1. tatimpaguesit me të ardhura vjetore bruto prej pesëmijë (5000) eurosh apo më pak: tridhjeteshtatë pikë pesë (37.5) euro për tremujor;

2.2. tatimpaguesit me të ardhura vjetore bruto mes pesëmijë e një (5.001) dhe pesëdhjetëmijë (50.000) eurosh nga të cilët nuk kërkohet apo të cilët nuk zgjedhin t'i përpilojnë pasqyrat financiare bëjnë pagesat tremujore si në vijim:

2.2.1. tre për qind (3%) të të ardhurave bruto për tremujor nga aktivitetet tregtare, bujqësore dhe aktivitetet e ngjashme komerciale;

2.2.2. pesë për qind (5%) të të ardhurave bruto për tremujor nga aktivitetet shërbyese, profesionale, të shkollave profesionale, zbatimëse dhe aktivitetet e ngjashme:

2.2.3. dhjetë për qind (10%) të të ardhurave bruto për tremujor nga aktivitetet e qirasë, të zvogëluara nga cilado shumë e mbajtur (e papaguar) gjatë atij tremujori në pajtim me paragrafin 2. të nenit 27 të këtij ligji;

2.3. tatimpaguesit me të ardhura vjetore bruto më të mëdha se pesëdhjetëmijë (50.000) euro dhe tatimpaguesit të cilët duhet t'i përpilojnë pasqyrat financiare apo ata të cilët zgjedhin t'i përpilojnë ato, bëjnë pagesat tremujore si në vijim:

2.3.1. një të katërtën (1/4) e detyrimit të përgjithshëm tatimor për periudhën tatimore në vijim bazuar në të ardhurën e tatueshme të vlerësuar dhe të zvogëluar nga cilado shumë e mbajtur (e papaguar) gjatë tremujorit në pajtim me nenin 27 të këtij ligji; apo

2.3.2. për periudhën e dytë dhe periudhat vijuese tatimore për të cilat tatimpaguesi bën pagesën sipas këtij paragrafi, një të katërtën (1/4) e njëqind e dhjetë për qind (110%) të detyrimit të përgjithshëm tatimor për periudhën tatimore që vie menjëherë pas periudhës tatimore vijuese, të zvogëluar nga cilado shumë e mbajtur (papaguar) gjatë tremujorit në pajtim me paragrafin 7. të nenit 2 të këtij ligji.

3. Tatimpaguesi i cili bën pagesën tremujore në avancë në pajtim me nën-paragrafin 2.2.3 të paragrafit 2. të këtij neni kryen rregullimin përfundimtar të tatimeve dhe paguan shumën e duhur më 1 prill apo para 1 prillit të vitit pas periudhës tatimore.

4. Shuma për rregullimin përfundimtar është shuma e përgjithshme e tatimit për periudhën tatimore e caktuar në përputhje me këtë ligj, minus shumat e mbajtura (të papaguara) në pajtim me nenin 27 të këtij ligji, që i janë paguar Administratës tatimore, dhe minus shumat e paguara në këste tremujore dhe krediti i jashtëm tatimor i lejuar sipas këtij ligji.

5. Nëse shumat e paguara në këste tremujore, plus krediti i huaj tatimor dhe plus cilado shumë e mbajtur (e papaguar) në pajtim me nenin 27 të këtij ligji që i është paguar Administratës tatimore është më e madhe se shuma e përgjithshme e tatimit e caktuar në përputhje me këtë ligj, tatimpaguesi ka të drejtën e kthimit të shumës së tepërt të tatimeve të paguara.

6. Nëse pagesat e kësteve tremujore bëhen në datën apo para datës së duhur dhe nëse pagesa përfundimtare për rregullimin e tatimit bëhet siç parashihet me paragrafit 3. të këtij neni, atëherë nuk kërkohet kurrfarë kamate apo dënimi për pagesë të pamjaftueshme nëse:

6.1. dallimi ndërmjet shumës së duhur për çdo këst dhe shumës së paguar në çdo këst nuk tejkalon dhjetë për qind (10%) të shumës së duhur; apo

6.2. pas periudhës së parë tatimore të taksapaguesit, shuma e paguar në çdo këst është dhjetë për qind (10%) më e lartë se një e katërta (1/4) e vlerës së tatimit të llogaritur prej Administratës tatimore për periudhën paraprake tatimore.

KREU X

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 32 Zbatimi

MEF mund të nxjerrë akte nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

Neni 33 Ligji në fuqi

Me hyrjen në fuqi të këtij ligj shfuqizohet çdo dispozitë që është në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 34 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi më 1 janar 2009.

**Ligji Nr. 03/ L-113
18 dhjetor 2008**

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI